

KËRKESË

Nr. 4582/1, datë 24.6.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit “truall”, që preken nga "Ndërtimi i linjave 110/220 kV që lidhin kaskadën e lumit Devoll me sistemin e transmetimit të energjisë së Republikës së Shqipërisë.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është “Devoll Hydropower” sh.a.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohen, pasurisë që dëmtohet dhe masën e kompensimit përkatës të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë për secilin pronar sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15 ditëve nga data e fundit e publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit.

MINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRIË
Damian Gjilknuri

Lista e pasurive qe shpronsohet nga ndertimi i linjes se transmetimit 110/220 kV per kaskaden e Devollit

[illegible]